



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE

Nr. 22. Prot.

Tiranë, më 15.01.2016.

Lënda: Mbi raportet e monitorimit për vitin 2015.

Drejtuar:

**MINISTRISË SË FINANCAVE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT
DREJTORISË SË ANALIZAVE DHE POLITIKAVE BUXHETORE**

TIRANË

Në mbështetje të ligjit nr.160/2014, datë 27.11.2014, "Për Buxhetin e vitit 2015", dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr 2 datë 06.02.2012 "Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr.2, datë 09.01.2015, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2015", për vitin 2015, performanca e produkteve të buxhetit të Gjykatës Kushtetuese, sipas programit buxhetor 03320, "Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese", paraqitet si më poshtë:

Programi 03320, "Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese"

Buxheti i akorduar për këtë program për vitin 2015, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2015-2017 dhe është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në DPP. Politika buxhetore e këtij programi, ka si qëllim realizimin e një procesi gjyqësor të pavarur, transparent në mbrojtje të kushtetutës dhe të drejtave themelore të njeriut nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës ndërtimore dhe elektronike të gjykatës për krijimin e kushteve optimale të punës e sigurisë për gjyqtarët dhe administratën.

Programi konsiston në mbështetjen buxhetore nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve e aktiviteteve buxhetore për mbështetjen e shërbimeve gjyqësore ndaj publikut me përmirësimin e infrastukturës së gjykatës dhe plotësimin e nevojave për mallra e shërbime me qëllim sjelljen e tyre në parametrat dhe cilësinë e performancës së BE.

Formati nr. 6, "Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për 6/mujorin e parë të vitit 2015".

Në zbatim të vendimit nr.1, date 20.01.2015, të Mbledhjes së Gjyqtarëve për detajimin e drejtimit kryesor të harxhimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2015, në zbatim të Ligjit Nr.160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", fondet e akorduara për veprimtarinë e gjykatës sipas artikujve, paraqiten në vijim:

1-Shpenzime Personeli

Në total fondi i shpenzimeve për paga e sigurime shoqërore nga 75,450 mijë lekë sipas buxhetit të rishikuar është realizuar 75,431 mijë lekë ose rreth 100 %, me një diferencë prej rreth -29 mijë lekë. Nga ky fond, shpenzimet për paga janë realizuar 67,172 mijë lekë nga 67,200 mijë lekë të programuara ose ≈100 %, me një diferencë prej rreth -28 mijë lekë, ndërsa shpenzimet për sigurimet shoqërore janë realizuar 8,259 mijë lekë nga 8,260 mijë lekë sipas buxhetit të rishikuar ose rreth 100 %, me një diferencë prej rreth -1 mijë lekë.

2-Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera

Fondi i shpenzimeve për mallra e shërbime të tjera nga 29,300 mijë lekë është realizuar 28,571 mijë lekë ose 98 %, me një diferencë prej -729 mijë lekë. Diferenca rrjedh nga mosharxhimi i plote i fondeve sipas destinacioneve të programuara, si dhe nga kursimet gjatë procesit të prokurimit.

3.- Shpenzime në investime

Fondi i investimeve nga 18,000 mijë lekë është realizuar për 17,849 mijë lekë ose rreth 99 %, me një diferencë prej -151 mijë lekë. Ky fond i detajuar paraqitet, si më poshtë:

në mijë/lekë

Nr.	Projekti	Plani	Fakti	Diferenca	
1	Rinovim i parkut të automjeteve	17,000	16,860	140	99 %
2	Pajisje zyre	500	499.1	-1	100 %
3	Libra dhe tituj të bibliotekës	500	490	-10	98 %
	Totali	18,000	17,849.1	-150.9	99 %

Siç duket edhe nga pasqyra e mësipërme investimet e programuara janë realizuar sipas zerave të parashikuar dhe në afatin e caktuar. Diferenca rrjedh nga kursimet si rrjedhojë e procesit të prokurimit.

Formati nr. 8 - Raporti i realizimit të produkteve të programit 03320

Formati nr. 9 - Raporti i shpenzimeve faktike të programit 03320, sipas produkteve

Në fund të vitit 2015, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me planin vjetor, në terma sasiorë paraqitet si më poshtë:

**% e realizimit,
kundrejt buxhetit vjetor**

▪ “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”	104,6 %
Totali i institucionit	104,6 %

Në programin “Veprimtaria gjyqësore kushtetuese”, 03320, janë përfshirë 4 produkte, performanca e të cilave në terma sasiorë paraqitet si më poshtë:

% e realizimit kundrejt buxhetit vjetor
Shpenzime korente Shpenzime kapitale Totali i shpenzimeve

▪ Programi “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”	105,3 %	100 %	104,6 %
Nga kjo:			
Produkti A	106,8 %		106,8 %
Produkti B			
Produkti C	100 %	100 %	100 %
Produkti D	100 %	100 %	100 %
Totali i institucionit	105,3 %	100 %	104,6 %

Produkti A “Vendimmarrja kushtetuese”- njësia matëse: nr.vendimesh.

Numri i vendimeve të parashikuara për vitin 2015 është 250. Ky parashikim nga ana e gjykatës është bërë, duke i u referuar tendencës së numrit të çështjeve për disa vite. Për këtë periudhë janë dhënë 267 vendime ose 106,8 %.

Produkti C - “Automjete të mirëmbajtura”- njësia matëse: nr. automjeteve të mirëmbajtura dhe të rinovuara.

Numri i automjeteve të mirëmbajtura është 15 dhe po kaq është edhe i realizuar ose 100 % e tyre, ndërsa numri i mjeteve të rinovuara është realizuar me 3 cope, aq sa është edhe programi ose 100 % e tij.

Produkti D - “Punonjës të motivuar”-njësia matëse: nr. Punonjësish+nr. paisjesh.

Në total ky produkt është realizuar në masën 100 %, ndërsa numri i punonjësve është realizuar 100 %. Investimet që përbëhen nga 26 tituj librash dhe 19 copë paisje për zyra janë realizuar 100 % e tyre.

Në terma vlerore, sipas zerave përberes të shpenzimeve, situata në fund të vitit 2015, paraqitet e tillë:

**% e realizimit,
kundrejt buxhetit vjetor**

▪ “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”	99,3 %
Totali i institucionit	99,3 %
Nga të cilat:	

	<u>Shpenzime korente</u>	<u>Shpenzime kapitale</u>	
▪ “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”	99,3 %	99,2 %	
Totali i institucionit	99,3 %	99,2 %	

Nga një vështrim i përgjithshëm, duke gjykuar vetëm mbi realizimin në vlerë të shpenzimeve të

planifikuara për vitin 2015, për programin “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese”, të këtij institucioni, evidentohet një performancë e mirë në realizimin e shpenzimeve vjetore.

Performanca e 4 produkteve kryesore në terma vlerore paraqitet si me poshtë:

Produkti A “Vendimmarrja kushtetuese”- njësia matëse: lekë.

Shpenzimet për këtë produkt për periudhën janar-dhjetor 2015, nga 48,720 mijë lekë janë realizuar 48,628 mijë lekë ose 99,8%.

Produkti C - “Automjete të mirëmbajtura”- njësia matëse: lekë.

Shpenzimet për mirëmbajtjen e automjeteve nga 11,300 mijë lekë janë realizuar 11,054 mijë lekë ose 97,8 %. Për shpenzimet kapitale nga 17,000 mijë lekë realizimi është 16,860 mijë lekë, duke realizuar rinovimin me 3 copë automjete të reja.

Produkti D - “Punonjës të motivuar”-njësia matëse: lekë.

Shpenzimet në total për këtë produkt nga 46,590 mijë lekë janë realizuar 45,159 mijë lekë ose 99,1 %. Shpenzimet operative për motivimin e punonjesve u realizuan 45,170 mijë lekë nga 45,590 mijë lekë ose në masen 99,1 %. Shpenzimet kapitale në këtë produkt nga 1,000 mijë lekë janë realizuar 989 mijë lekë ose 98,9 %. Performanca e këtij produkti është mire dhe në mënyrë të përmbledhur performanca e produkteve të programit 03320, jepet në pasqyrën e mëposhtme:

% e realizimit kundrejt buxhetit vjetor
Shpenzime korente Shpenzime kapitale Totali i shpenzimeve

<ul style="list-style-type: none"> ▪ Programi “Veprimtaria gjyqësore, kushtetuese” Nga kjo: Produkti A Produkti B Produkti C Produkti D Totali i institucionit 	<p>99,3 %</p> <p>99,8 %</p> <p>97,8 %</p> <p>99,1 %</p> <p>99,3 %</p>	<p>99,2 %</p> <p></p> <p>99,2 %</p> <p>98,9 %</p> <p>99,2 %</p>	<p>99,3 %</p> <p>99,8 %</p> <p>98,6 %</p> <p>99,1 %</p> <p>99,3 %</p>
--	--	--	--

Krahasimi i të dhënave faktike, të raportit të institucionit me të dhënat e thesarit, për të njëjtën periudhë raportuese.

Në milion lekë

Programet	Shpenzimet korente			Shpenzimet kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Institucioni	Thesari	Dif.	Institucioni	Thesari	Dif.	Institucioni	Thesari	Dif.
Veprimtaria gjyqësore kushtetuese	104.851	104.851	0.00	17.849	17.849	0.00	122.700	122.700	0.00
Totali i institucionit	104.851	104.851	0.00	17.849	17.849	0.00	122.700	122.700	0.00

Ashtu siç shikohet edhe nga tabela e mësipërme, të dhënat e raportuara nga Gjykata Kushtetuese në tabelat e monitorimit të shpenzimeve për vitin 2015, përputhen plotësisht me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit.

Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit.

Për programin e këtij institucioni, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjate 3/mujorit të pare të vitit 2015, përfshirë këtu buxhetin fillestar, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në milion lekë

Programet	Buxheti fillestar 2015	Buxheti me ndryshime	Diferenca
Veprimtaria gjyqsore kushtetuese	120,100	123,610	+3,510
Totali i institucionit	120,100	123,610	+3,510

Diferenca prej **+3,510 mln lekë** është rezultat i ndryshimeve në buxhetin e vitit 2015, si me poshte:

- Shtesa e buxhetit me VKM nr.819, date 07.10.2015 +6,000 mln leke
Nga kjo:
 - ÷Shtesa e shpenzimeve kapitale +6,000 mln leke
- Shtesa e buxhetit nga perdorimi i fondit te veçante +0,050 mln leke
- Pakesimi i buxhetit me aktin normative nr.3/2015, date 28.12.2015 -2,540 mln leke
Nga keto:
 - ÷Pakesimi i shpenzimeve per paga(600) -1,500 mln leke
 - ÷Pakesimi i shpenzimeve per sigurimet shoqerore(601) -0,940 mln leke
 - ÷Pakesimi i shpenzimeve per transferta korrente te huaja(605) -0,100 mln leke

Nuk ka diferenca me thesarin.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
KUJTIM OSMANI**